



**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI  
(Auditim Tematik)**

**“Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2022, në  
Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kukës”**



<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	
<b>II.</b>	<b>Hyrje.....</b>	<b>3-5</b>
	<b>a. Titulli</b>	
	<b>b. Marrësi</b>	
	<b>c. Objektivat dhe qëllimi</b>	
	<b>d. Identifikimi i çështjes</b>	
	<b>e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese</b>	
	<b>ë. Përgjegjësitë e audituesve</b>	
	<b>f. Kriteret e vlerësimit</b>	
	<b>g. Standardet e Auditimit</b>	
	<b>h. Metodatat e auditimit</b>	
	<b>i. Dokumentimi i auditimit</b>	
<b>III.</b>	<b>PERSHKRIM I AUDITIMIT</b>	
<b>I.</b>	<b>Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim .....</b>	<b>5</b>
<b>II.</b>	<b>Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit .....</b>	<b>5-11</b>
II.1	Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".	
II.2	Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.	
II.3	Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	
II.4	Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.	
II.5	Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.	
II.6	Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.	
II.7.	Probleme të ndryshme të dala gjatë auditimit.	
<b>IV.</b>	<b>GJETJET DHE REKOMANDIMET.....</b>	<b>11-18</b>



## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në zbatim të nenin 15 shkronja (j) dhe pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit", të Programit të Auditimit nr. nr. 326 datë 04.04.2023 nga data 05.04.2023, u krye auditimi mbi hartimin e plan veprimit dhe raportimit në KLSH mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna për përmirësimin e legjislacionit, marrjen e masave organizative, të masave disiplinore dhe të zhdëmtimit, të rekomanduara në përfundimet e auditimit nga KLSH për misionin e mëparshëm të realizuar në këtë objekt, ku rezultoi se:

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 27 rekomandime gjithsej, nga këto: 14 masa organizative, 2 rekomandime për 3 E, si dhe është rekomanduar masa disiplinore "vërejtje deri në largim nga puna" për 10 punonjës.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 14 masa organizative, nga të cilat, nga subjekti janë pranuar 14, ndërsa zbatimi tyre rezulton: janë zbatuar plotësisht 13 rekomandime, janë në proces zbatimi 1 rekomandim.

- Për të ardhura të munguara(3 E) janë lënë 2 rekomandime për shumën 1,852,900 lekë, nga të cilat, 2 rekomandime janë në proces zbatimi.

- Për shkeljet e konstatuara janë rekomanduar masa disiplinore "Vërejtje deri në largim nga puna" për 10 punonjës, nga ku rezulton se nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Tiranë, nuk është dërguar njoftim për fillimin e procedurave për marrjen e masave disiplinore të rekomanduara, për rrjedhojë konsiderohen të pa zbatuara.

### I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Në 16 raste, legalizimi i objekteve informale është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, konkretisht:</p> <p>- Në 4 raste, janë kryer legalizime të objekteve sipas Lejeve të Legalizimit me nr. 57842, datë 27.12.2018; nr. 39193, datë 24.05.2018; nr. 57853, datë 30.01.2019; nr. 62592, datë 25.10.2019, pa respektuar distancat nga rrugët, në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, neni 39 "Përjashtimi nga legalizimi" me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje" kreu III. "Kriteret për legalizimin e ndërtimeve jashtë zonave informale të miratuara", pika 4/b ,Ligjin Nr.8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar "Kodi rrugor në Republikën e Shqipërisë", neni 2 "Përcaktime dhe klasifikime rrugësh" dhe neni 4, "Përcaktimi i qendrave të banuara", VKM nr. 153, date 07.04.2000 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë" neni 25, pika 2; ndërkohë që në dosje nuk ka korrespondencë shkresore me</p>		E lartë	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kukës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, në përputhje me nenin 76 "Kontrolli administrativ" të ligjit 20/2020, datë 05.03.2020 të ushtrisë kontrollin administrativ dhe në bazë të nenin 18 të marrë masa për s'kualifikimin e objekteve informale të pajisura me leje legalizimi në 16 raste si më lart. Gjithashtu për pasuritë e regjistruara sipas lejeve legalizimi konstatuar të lëshuara me shkelje në 16 raste të marrë masa, të nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE  
RAPORT PËFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË ASHK  
KUKËS

<p>Autoritetin Rrugor Shqiptar për të përcaktuar nëse parcela ndërtimore bie në rrugë apo mbi projektin infrastrukturor,</p> <p><b>Në 1 rast</b> është kryer legalizim i objektit informal sipas lejes së legalizimit nr. 33925, datë 27.11.2019, <b>në territor të institucioneve publike</b>, pasi sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, rezulton se objekti i legalizuar prek projektin konkret të infrastrukturës rrugore si dhe ndodhet i përfshirë në Planin e Përgjithshëm Vendor i të Bashkisë Kukës miratuar me Vendimin e KKT nr. 8, datë 08.02.2017, Rregulloren e Plani të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kukës, është zona <b>Sh.13.8, ku përdorimet “Shëndetësi” dhe nuk lejohen ndërtime banimi</b>. Në kundërshtim me VKM nr. 280, datë 01.04.2015, e ndryshuar, Kreu II, pika 2.c; si dhe nenin 18 të ligjit 20/2020, datë 05.03.2020.</p> <p><b>Në 2 raste</b> është marrë Vendim për kualifikim të objekteve informale sipas Vendimeve nr. 113, datë 28.06.2021 “Për legalizimin e ndërtimit pa leje” në posedim të A.P”, si dhe “Për legalizimin e ndërtimit pa leje” në posedim të F.C”, pasi objektet e legalizuara bien sipas Planit të Përgjithshëm Vendor në njësinë strukturore IN.7 <b>“Infrastrukturë rrugë lokale “F” dhe zona AR.9.4, ku përdorimet “Infrastrukturë Turistike”</b> Në kundërshtim me VKM nr. 1040, datë 25.11.2020 në Kreun II, pika 15.gj dhe pika 24.</p> <p><b>Në 1 rast</b> është marrë Vendim për kualifikim të objektit informal sipas Vendimit nr. 56, datë 30.03.2021 <b>në buzë kanali</b>, pasi nga DVASHK Kukës nuk është përcaktuar statusi i kufitarit nga lindja “Përrua” apo Kanal kryesor ose ndihmës kjo në përputhje e zbatim me VKM 1040, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”, kreu III, pika 18, gërma ë; si dhe të ligjit 24/2017, neni 46, pika ç.</p> <p><b>Në 7 raste</b> janë lëshuar leje legalizimi si dhe janë marrë Vendime Kualifikimi sipas lejeve të legalizimit me nr. 62592, datë 25.10.2019; nr. 62848, datë 25.08.2020; nr. 62814, datë 19.06.2020; me nr. 62849, datë 23.08.2020; nr. 58119, datë 18.03.2019; si dhe Vendimeve të Kualifikimit Vendimit me nr. 113, datë 28.06.2021 dhe Vendimit nr. 56, datë 30.03.2021 në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kukës miratuar me Vendimin e KKT nr. 8, datë 08.02.2017, konkretisht <b>ku përdorimet lejohen “Tokë Bujqësore”; “Sistem Natyror” si dhe “Park Natyror Urban” dhe nuk lejohen ndërtime</b>. Veprime në kundërshtim me nenin 14, të ligjit nr. 9244, datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, të ndryshuar dhe me nenin 11/1, pikat 4, 4/1, 4/2 të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionet e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar.</p> <p><b>Në 1 rast</b> sipas Lejes së Legalizimit nr. 58119, datë 18.03.2019 nga Drejtoria Vendore e ASHK Kukës është llogaritur vlera e Parcelës Ndërtimore për kalimin e pronësisë në datë 30.01.2019 me çmimin preferencial prej 2,000 lekë/m<sup>2</sup> ose me 50 % të vlerës prej 5,280 lekë/m<sup>2</sup> referuar VKM nr. 89, datë 03.02.2016. Veprime në shkelje të legjisllacionit të sipër përmendur pasi 3 fish i ndërtimit është (44 x 3) 132 m<sup>2</sup> dhe pjesa tjetër n.q.s. tereni nuk e lejon ndarjen duhet të paguhet në përputhje me neni 17 të ligjit nr. 9482/2006 me ndryshime, nga ku <b>janë krijuar të ardhura të munguara prej 369,820 lekë+bono</b> { 859,320 lekë detyrimi – 489,500 lekë të llogaritura e paguar} pasi detyrimi duhet të ishte 859,320 lekë{( 132 m<sup>2</sup> x 2000 lekë )+(112.75 x 5,280)}</p>		
---	--	--



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE  
RAPORT PËFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË ASHK  
KUKËS

2	<p>Nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kukës (ish- Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Kukës) për periudhën objekt auditimi, janë lëshuar 468 leje legalizimi për objektet informale të legalizuara. Nga 468 leje legalizimi të lëshuara, për parcela ndërtimore në total prej 3134.85 m<sup>2</sup> lejet e legalizimit janë me shënimin “Kalimi i pronësisë për parcelën ndërtimore do miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave”, nisur nga çmimet e tokës truall për këto zona, sipas Vendimit të KM nr. 89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, dhe për sipërfaqet e parcelave ndërtimore, rezultojnë një shumë që duhet paguar prej subjekteve informale në vlerën 1,483,098 lekë veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, neni 17 ( pika 5 ), si dhe ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020</p>		E lartë	<p>Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kukës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së Tiranë, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore deri në daljen e VKM-ve, për parcelat ndërtimore prej 3134.85 m<sup>2</sup> të pajisur me Leje legalizimi të objektit, <b>për të mundësuar brenda afateve ligjore</b> likuidimin të vleftës përkatëse prej 1,483,098 lekë të parcelave ndërtimore..</p>
3	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të administruar sipas Lejes së Legalizimit nr. 58119, datë 18.03.2019, u konstatua se, nga Drejtoria Vendore e ASHK Kukës është llogaritur vlera e Parcelës Ndërtimore për kalimin e pronësisë në datë 30.01.2019 me çmimin preferencial prej 2,000 lekë/m<sup>2</sup> ose me 50 % të vlerës prej 5,280 lekë/m<sup>2</sup> referuar VKM nr. 89, datë 03.02.2016. Veprime në shkelje të legjislacionit të sipër përmendur pasi 3 fish i ndërtimit është (44 x 3) 132 m<sup>2</sup> dhe pjesa tjetër n.q.s. tereni e nuk lejon ndarjen duhet të paguhet në përputhje me neni 17 të ligjit nr. 9482/2006 me ndryshime, nga ku janë krijuar të ardhura të munguara prej 369,820 lekë+bono { 859,320 lekë detyrimi – 489,500 lekë të llogaritura e paguar} pasi detyrimi duhet të ishte 859,320 lekë{( 132 m<sup>2</sup> x 2000 lekë )+(112.75 x 5,280)}</p>			<p>Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kukës, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore, <b>për të mundësuar likuidimin e vlerës</b> prej 369,820 lekë+bono.</p>

### 1.3. Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit

Nga ana e KLSH me shkresw n përcjellëse nr. 1222/9, datw 06.06.2022, janë lënë 26 rekomandime gjithsej, nga këto: 14 masa organizative; 2 masa rakomanduese me 3 E, dhe janë rekomanduar masa disiplinore “Vërejtje deri në largim nga puna”, për 10 punonjës. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 14 masa organizative, nga të cilat, nga subjekti janë pranuar 14, ndërsa zbatimi tyre rezultojnë: janë zbatuar plotësisht 13 rekomandime dhe në proces zbatimi 1 rekomandim;

Për eliminimin e efekteve negative dhe për administrimin e menaxhimin në përmbushje të 3 E, janë lënë 2 masa rakomanduese, të cilat rezultojnë në proces zbatimi.

Për shkeljet e konstatuara janë rekomanduar masa disiplinore “Vërejtje deri në largim nga puna”, për 10 punonjës, të cilat rezultojnë të pa zbatuara;

Për zbatimin e këtyre rekomandimeve DVASHK Kukës ka nxjerrë: urdhëra kufizimi për pasuritë, sipas rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH”Ky urdhër ka përmbajtjen e një plan veprimi ku ngarkohen specialistet, dhe përgjegjësit e sektorëve për zbatimin e këtij urdhri.

## II – HYRJE

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 326 datë 04.04.2023 nga data 05.04.2023 deri në datën 28.04.2023, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE  
RAPORT PËFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË ASHK  
KUKËS

Kadastrës Kukës, KLSH kreu auditimin e përputhshmërisë "Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2022".

Auditimi përputhshmërisë u krye nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. L.K, Përgjegjës Grupi
2. R.K, auditues
3. B.B, auditues
4. R.A, auditues
5. F.Ç, auditues

Nga grupi i auditimit u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit, një kopje e të cilit i dërgohet DVASHK Kukës dhe një kopje protokollohet në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

**1. Titulli** - Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e ushtruar sipas programit nr. 1221/1, datë 22.11.2021, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

**2. Marrësi** – Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, **Kukës**

### 3. Objektivat dhe qëllimi

**Objektivat:** Mbi dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të kryer në Drejtorinë e Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Kukës, si dhe dhënien e opinionit objektiv e profesional mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH në përmirësimin e punës menaxhuese të njësisë publike.

**Qëllimi:** Raportimi dhe evidentimi i gjetjeve, nxjerrja e konkluzioneve dhe rekomandimet e auditimit.

### 4. Identifikimi i çështjes

Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kukës është person juridik, publik jobuxhetor, në varësi të ASHK dhe ka për objekt të veprimtarisë:

1. Administrimin e vetëdeklarimeve; procedurat e përditësimit në terren dhe hartimit të dokumentacionit; procesi i rregullimit ligjor të situatës, midis poseduesve të ndërtimeve pa leje dhe pronarëve trualli i të cilëve është zënë nga ndërtime informale; lëshimin e lejeve të legalizimit si dhe bashkëpunimin me institucionet e përfshira në procesin e legalizimit.

Në periudhën objekt auditimi nga DR ALUIZNI-t Kukës janë lëshuar 468 leje legalizimi nga të cilat është legalizuar vetëm objekti, ndërsa janë në pritje 3134.85 m<sup>2</sup> te kalimit të pronësisë dhe likuidimin e parcelës ndërtimore.

2. Shërbimin ndaj publikut, regjistrimin e pasurive të paluajtshme, organizimin e institucionit dhe mënyrën e administrimit të kadastrës, si regjistër publik i pasurive të paluajtshme.

Aktivitetet që vlerësohen sipas kriterëve të vlerësimit mbështetur në burimet e përdorura (ZVRPP Shkodër, DV e ASHK Kukës) janë sipas të dhënave të marra nga evidenca mbi të ardhurat nga shërbimet e aplikuara për vitet 2019-2021, rezulton se pjesa kryesore i takon të ardhurave nga lëshimi i certifikatave të pronësisë, lëshim kopje kartelet të pasurisë, lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale, regjistrim i objekteve të legalizuara.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara që i përket mjaftueshmërisë e përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.





## 5. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar

Struktura drejtuese e subjektit DVASHK Kukës, është përgjegjëse për përdorimin e burimeve njerëzore dhe financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara.

Për veprimtarinë e kryer në lidhje me procedurat e ndjekura për legalizimin e objekteve pa leje dhe shtesave vertikale dhe horizontale në objektet me leje ndërtimi.

Për ish ZVRPP Kukës, lidhur me veprimtarinë e kryer për pranimin e dokumentacionit, regjistrimin dhe transaksionet e pasurive, në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

## 6. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e audituesve është dhënia e opinionit mbi problematikat e trajtuara të çështjeve nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi duhet të respektojë kërkesat etike, duke planifikuar e kryer auditimin me qëllim arritjen e nivelit të sigurisë së kërkuar.

## 7. Kriteret e vlerësimit

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar, në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikat e trajtuara, janë marrë në konsideratë si kriter vlerësues, Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i ndryshuar; Rregullorja e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, e ndryshuar me Vendimin nr.107, datë 08.09.2017 të Kryetarit Të KLSH-së; Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr.67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), "Udhëzuesit e INTOSAI-t"; Udhëzues të përgjithshëm dhe specifik për auditimin, si dhe në praktikën më të mira ndërkombëtare të fushës së auditimit publik; Ligj nr. 20/2020, datë 05.03.2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"; Ligji nr. 111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën"; Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar; Ligj nr. 10186, datë 05.11.2019 "Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin", i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.

## 8. Standardet e auditimit

Auditimi bazohet në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit nr.107, datë 08.08.2017, Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr.67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI.

## 9. Metodatat e auditimit

Për arritjen e objektivave, audituesit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit dhe në procedurat analitike. Metodatat e përdorura gjatë auditimit në arritjen e konkluzioneve janë:

*Auditim i plotë sipas cilësimeve të bëra në drejtimet e auditimit.*

*Verifikimi i Urdhrave, Udhëzimeve dhe çdo dokumenti ligjor të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve.*



## 10. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 "Dokumentimi i Auditimit". Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundur natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Konkluzionet janë arritur duke u bazuar në rezultatet e procedurave të kryera dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe në çështjet e rëndësishme që dolën gjatë auditimit. Gjatë auditimit në terren nga grupi i auditimit është mbajtur një akt-verifikim sipas çështjeve respektive të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit. Në përfundim të punës në terren është kryer takimi përmbyllës me përfaqësuesit e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

## INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM.

DVASHK Kukës është person juridik, publik jobuxhetor, në varësi të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) dhe ka për detyrë regjistrimin e titujve të pronësisë dhe legalizimin e objekteve informale të ndërtuara territorin brenda juridiksionit të Drejtorisë dhe kalimin e pronësisë të trojeve në Kukës në bazë të kushteve të përcaktuara nga Ligji nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën" dhe Ligji nr.20/20, datë 05.03.2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë". Komplexiteti i trajtimit të pronës ka të bëjë me natyrën ekonomike, sociale si dhe juridike dhe që konsiderohet si një element bazik shtetformues, por në terësinë e të cilës ndërthuren edhe të drejtat private e publike. Trajtimi i pronës përbën një detyrim publik nga njëra anë (në aspektin e evidentimit dhe regjistrimit) dhe nga ana tjetër një të drejtë private (në aspektin e përfitimit). Po ashtu natyra tejet komplekse dhe specifike e pasurive të paluajtshme ka të bëjë edhe me trajtimin e elementëve përbërës për regjistrimin me natyrë juridike dhe teknike të pasurisë së paluajtshme, si dhe nga problemet e krijuara dhe mbartura si pasojë e ndryshimit të sistemeve dhe ligjeve, procedurave për regjistrimin pjesërisht të pronës në sistemin e ri të regjistrimit dhe pjesërisht në regjistrat e vjetër hipotekorë, larmishmëria e madhe e kategorive të resurseve të pronës, e titujve juridikë të prodhuar ndër vite nga institucionet shtetërore me natyrë administrative, si dhe dokumentacionit tekniko-ligjor apo hartave etj. në mbështetje të këtyre titujve, si dhe konflikteve të ndryshme të shfaqura me natyrë administrative apo civile, dhe jo në pak raste edhe penale.

**Fushëveprimi i këtij auditimi** përfshin të gjithë aktivitetin e aparatit të Drejtorisë Vendore të ASHK Kukës: për zbatimin e procedurave në dhënie të lejeve të legalizimit, për regjistrimin e pasurive, në zbatim të akteve administrative lëshuar nga organet që e kanë në kompetencë dhe vendimeve të gjykatave të formës së prerë, për periudhën objekt auditimi, në raste të veçanta edhe para kësaj periudhe.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, duke vlerësuar evidencat e grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme e të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë e DVASHK Kukës.





## KONTROLLI I LARTË I SHQITIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE  
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË ASHK  
KUKËS

### III-PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

**Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".**

Programi i Auditimit nr. 326, datë 04.04.2023, u krye auditimi mbi hartimin e plan veprimit dhe raportimit në KLSH mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna për përmirësimin e legjislacionit, marrjen e masave organizative, të masave disiplinore dhe të zhdëmtimit, të rekomanduara në përfundimet e auditimit nga KLSH për misionin e mëparshëm të realizuar në këtë objekt, ku rezultoi se:

Në përfundim të Auditimit me shkresën përcjellëse nr. 1222/9, date 06.06.2022, është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet për auditimin e ushtruar me programin nr.1222/1 prot., datë 22.11.2021, i ndryshuar.

Në zbatim të nenit 15, shkronja j, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", brenda 20 ditëve nga marrja e shkresës, nga ana e Drejtorinë Vendore të ASHK Kukës nuk është kthyer përgjigje lidhur me hartimin e programit të punës dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH, personat përgjegjës dhe afatet e zbatimit.

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 27 rekomandime gjithsej, nga këto 14 masa organizative, 2 rekomandime për 3 E; si dhe është rekomanduar masa disiplinore "vërejtje deri në largim nga puna" për 10 punonjës.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 14 masa organizative, nga të cilat, nga subjekti janë pranuar 14, ndërsa zbatimi tyre rezulton: janë zbatuar plotësisht 13 rekomandime, në proces zbatimi 1 rekomandim.
- b. Për të ardhura të munguara (3 E) janë lënë 2 rekomandime për shumën 1,852,900 lekë, nga të cilat, 2 rekomandime janë në proces zbatimi.
- c. Për shkeljet e konstatuara janë rekomanduar masa disiplinore "vërejtje deri në largim nga puna", për 10 punonjës, nga ku rezulton se nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Tiranë, nuk është dërguar njoftim për fillimin e procedurave për marrjen e masave disiplinore të rekomanduara.

*Për zbatimin e këtyre rekomandimeve nga DVASHK Kukës janë nxjerrë 24 urdhëra kufizimi për pasuritë, sipas rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH*

	Emërtimi	Rekomandimet ne numër :					Nga rekomandimet gjithsej: Sa me dëme ekonomike									
		Rekomandim gjithsej	Nga rekomandimet janë:				Nga rekomandimet janë:									
			Zbatuar	Në proces /pjesërisht	Pa pranuar	Pa zbatuar	Rekomanduar Gjithsej		Zbatuar arkëtuar				Zbatuar pjesërisht (në proces)		Pa zbatuar	
							Nr. pers	Në mijë/lek	Nr. per	Në mijë/lek	Nr. Pers	Në mijë/lek	Nr. pers	Në mijë/lek		
1.	Masa organizative	14	13	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-		
2.	Masa për përmirësim ligjor	0	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-		
3.	Shpërblim demi	0	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-		
4.	Masa efekt financiar	2	-	2	-	-	1,852	-	-	-	-	-	-	1.852		
5.	Masa disiplinore	10	-	-	-	10	-	-	-	-	-	-	-	-		
	<b>Totali</b>	<b>26</b>	<b>13</b>	<b>3</b>	<b>-</b>	<b>10</b>	<b>1,852</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>1,852</b>		



*Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.*

## **MASA ORGANIZATIVE**

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kukës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore deri në daljen e VKM-ve, për parcelat ndërtimore prej 3134.85 m<sup>2</sup> të pajisur me Leje Legalizimi të objektit, **për të mundësuar brenda afateve ligjore** likuidimin të e vleftës përkatëse prej 1,483,098 lekë të parcelave ndërtimore.

*Deri 30.9.2022*

**Koment: Zbatuar:** *Nga gjetjet nga auditimi pika 1 ku nga 468 leje legalizimi te leshuara per periudhen e auditimit rekomandimi per dergimin per ndjekjen e procedurave per kalimin e pronesise se parces ndertimore deri ne daljen e VKM-ve, eshte bere nxerrja e dosjeve me lejet e legalizimit te leshuara dhe duke qene se periudha e auditimit ka rezultuar me ndryshimet ligjore eshte bere evidentimi i dosjeve te cilet jane ne toke te te treterve per te cilet ne zbatim te ligjit 20/2020 neni 22 pika 6 "6. Për parcelat ndërtimore që shtrihen në truall privat, në pronësi të të tretëve, kalimi i së drejtës së pronësisë realizohet në çastin e hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për kompensimin e pronarëve joposedues. Deri në atë çast, ndërtimi regjistrohet pa marrëdhënie me truallin." ka filluar procedura e kalimit te pronesise se parces ndertimore dhe shpronësimi i pronareve.*

*Per lejet e legalizimit te cilet ndodhen ne nenin 22, pika 2 te ligjit 20/2020 "2. Kur poseduesi i ndërtimit nuk është pronar i parcelës ndërtimore, akti i legalizimit të ndërtimit nga ASHK-ja shërben edhe si akt i kalimit të pronësisë mbi truallin e parcelës." Ka vijuar emetimi i faturave te parcelave ndertimore.*

**2.1- Rekomandimi:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kukës, të marrë masa që në vazhdimësi për objekte informale të pajisur me leje legalizimi të evidentojë respektimin e afateve të matjeve në terren, kualifikimin e tyre deri në lëshimin e lejes së legalizimit, si dhe për objektet informale për të cilat kanë përfunduar evidentimin faktik në terren të ndërtimeve pa leje, evidentimi i gjendjes juridike të truallit, si dhe hartimi i genplanit dhe planimetricave, por përfunduar procesi i legalizimit, të operojë me vazhdimin e procedurave të legalizimit, duke i trajtuar në funksion të afatit kohor të qëndrimit në arkivë si dhe të bëhet dokumentimi i vazhdueshëm i lëvizjes së dosjeve që futen dhe nxirren nga arkiva për punë.

*Në vijimësi*

**Koment: Zbatuar:** *Nga gjetjet nga auditimi pika 2 nga ana e Drejtorise Vendore e ASHK-se Kukes jane marre masa qe ne vazhdimësi te trajtohen sipas afateve kohore nga nxjerrja e dosjes nga arkiva deri ne leshimin e lejeve te legalizimit.*

**3.1. Rekomandimi:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kukës të marrë masa për 16 rastet e konstatuara e në vijim, për të plotësuar "Proces verbalin e verifikimit në terren të të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje", me të dhënat e kërkuara edhe me largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij. Në rastin e mos plotësimit, të bashkëpunojë me Drejtorinë e



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE  
RAPORT PËFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË ASHK  
KUKËS

Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për objektet informale të pajisura me leje legalizimi për të filluar procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit.

**Deri 30.06.2022**

**Koment: Zbatuar.** Nga gjetjet nga auditimi pika 3 per 16 raste "Proces verbali i verifikimit ne terren" i te dhenave te ndertimit pa leje është kryer në përputhje me Urdhërin nr 30 date 15.01.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm te Aluizni-t, dhe sipas VKM Nr. 589 Datë 10.09.2014, i ndryshuar me Vendim nr. 634 datë 07.09.2016, "Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale". Kështu, veme ne dukje se, siç paraqitet ne kopjen e skicës fushore të GenPlanit, janë plotësuar të gjitha distancat e objektit nga kufinjte e parcelës, si dhe objektet te paraqitur me nr. katesh dhe emrat e poseduesve te tyre. Ndërkohë që në proces-verbalin e verifikimit në terren, kufitarët janë plotësuar me një nga mënyrat e paraqitjes së tyre.

**4.1. Rekomandimi:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kukës të marrë masa dhe të përgatisë plane konkrete, për të shqyrtuar kërkesat për legalizim sipas zonave informale dhe brenda afateve të përcaktuara ligjërisht, duke mundësuar afrimin e shërbimit të kërkuar nga qytetarët në kohë duke rritur edhe transparencën për publikun.

**Në vijimësi**

**Koment: Zbatuar:** Nga gjetjet nga auditimi pika 4 nga ana e Drejtorise Vendore e ASHK-se Kukes jane marre masa qe ne vazhdimesi te trajtohen sipas afateve kohore nga nxjerrja e dosjes nga arkiva deri ne leshimin e lejeve te legalizimit.

**5.1 Rekomandimi:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kukës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, në përputhje me nenin 76 "Kontrolli administrativ" të ligjit 20/2020, datë 05.03.2020 të ushtrorë kontrollin administrativ dhe në bazë të nenin 18 të marrë masa për s'kualifikimin e objekteve informale të pajisura me leje legalizimi në 16 raste si më lart. Gjithashtu për pasuritë e regjistruara sipas lejeve legalizimi konstatuar të lëshuara me shkelje në 16 raste të marrë masa, të nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

**Menjëherë**

**Koment: Zbatuar pjesërisht,** janë vendosur kufizime por nuk është bërë shqyrtimi administrativ.

**6.1.Rekomandimi:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kukës, të marrë masa që të rivlerësojë procedurat e kalimit të pronësisë dhe në referencë të akteve ligjore e nënligjore, të vlerësojë procedurat për shfuqizimin e Vendimeve me nr. 13, datë 28.06.2019; nr. 17, datë 20.08.2019; nr. 19, datë 20.08.2019; nr. 10, datë 20.05.2019; nr. 07, datë 09.05.2019; nr. 08, datë 09.05.2019, ndërsa për pasurinë e regjistruar, të nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor. Gjithashtu të ngrihet një grup pune për të verifikuar saktësisht në terren gjendjen e objekteve ndërtesë, të kaluar në pronësi, si dhe të kufizohen veprimet mbi pasurinë deri në arritjen e konkluzionit përfundimtar.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Koment: Zbatuar.** per 6 raste te per objektet e ndertuara para vitit 1991 nga ana e Drejtorise Vendore e ASHK-se Kukes jane nxjerre urdherat e kufizimit, jane bere njoftimet mbi urdherat si dhe shenimet perkatese ne kartelat e pasurise ku jane regjistruar keto pasuri.



**7.1.Rekomandim:** Drejtoria e Drejtorisë Vendore të ASHK Kukës të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e sipërcituara, regjistruar me referencat nr. 0048, datë 10.10.2021; nr. 0014, datë 30.01.2020; nr. 012, datë 23.01.2020; nr. 100 datë 10.01.2021; nr. 63 datë 12.06.2020; nr. 62 datë 17.01.2020; nr. 259, datë 16.08.2021; nr. 1360 datë 16.09.2021; nr. 650 datë 23.05.2017; nr. 1 datë 08.07.2020 deri në plotësimin me dokumentacionin ligjor, ose në të kundërt këto prona të kthehen me status të gjendjes fillestare.

**Deri 30.06.2022**

**Koment:** Zbatuar: Për 3 raste për të cilat mungon çertifikata origjinale që tregon gjendjen familjare të datës 01.08.1991 janë kufizuar pasuritë si më poshte.

1. Pasuria Nr.1165 në zonën kadastrale 2830 Orgjost me Urdhërin Nr.194 datë 20.06.2022 si dhe është njoftuar pronari Q.M.P me njoftimin Nr.1463 datë 20.06.2022.

2. Pasuria Nr.172/1 në zonën kadastrale 1350 Çajë me Urdhërin Nr.197 datë 20.06.2022 si dhe është njoftuar pronari I.S.M me njoftimin Nr.1469 datë 20.06.2022.

3. Pasuria Nr.505 në zonën kadastrale 3773 Vilë me Urdhërin Nr.196 datë 20.06.2022 si dhe është njoftuar pronari F.Q.B me njoftimin Nr.1467 datë 20.06.2022.

Për 3 raste për të cilat nuk është hapur kartelë e re ..janë kufizuar pasuritë si më poshtë:

1. Pasuria Nr.402/3 në zonën kadastrale 1653 Fush Arë me Urdhërin Nr.201 datë 20.06.2022 si dhe është njoftuar pronari E.O.V me njoftimin Nr.1477 datë 20.06.2022.

2. Pasuria Nr.402/2 në zonën kadastrale 1653 Fush Arë me Urdhërin Nr.202 datë 20.06.2022 si dhe është njoftuar pronari A.H.V me njoftimin Nr.1479 datë 20.06.2022.

3. Pasuria Nr.8/3 në zonën kadastrale 1011 Aliaj me Urdhërin Nr.203 datë 20.06.2022 si dhe është njoftuar pronari A.Z.L me njoftimin Nr.1481 datë 20.06.2022.

Për 1 rast .. referenca 259 është kufizuar pasuria e mëposhtme:

4. Pasuria Nr.1210 në zonën kadastrale 1178 Bicaj me Urdhërin Nr.195 datë 20.06.2022 si dhe është njoftuar pronari E.R.B me njoftimin Nr.1465 datë 20.06.2022.

Për 1 rast .. referenca nr.1360 është kufizuar pasuria e mëposhtme:

5. Pasuria Nr.3533/1 në zonën kadastrale 3425 Shtiqën me Urdhërin Nr.198 datë 20.06.2022 si dhe është njoftuar pronari V.M me njoftimin Nr.1471 datë 20.06.2022.

Për 1 rast referenca nr.650 është kufizuar pasuria

**8.1. Rekomandimi:** Drejtoria Vendore e ASHK Kukës, të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë me nr. Pas.24/32-N11 ,Vol.35,Fq.235, Z.K. 2315; nr. Pas.24/32-N12 ,Vol.35,Fq.236, Z.K. 2315; nr. Pas.24/32-T ,Vol.35, Fq.237, Z.K. 2315, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor dhe të fillojë procedurat për rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit janë regjistruar pasuritë, duke njoftuar subjektet për fillimin e procedurave përkatëse sipas kërkesave të ligjit nr. 111/2018 "Për Kadastrën".

**Deri 30.06.2022**

**Koment:** Zbatuar: Janë kufizuar pasuritë si më poshtë:

Pasuria Nr.24/32-N12 dhe pasuria Nr.24/32-T në zonën kadastrale 2315 Kukës me Urdhërin Nr.204 datë 20.06.2022 si dhe janë njoftuar b/pronari Xh.E.C me njoftimet Nr.1490 datë 20.06.2022 deri Nr..

**9.1. Rekomandimi:** Drejtoria Vendore e ASHK Kukës, të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë nr. Pas.39/74+2-6,Vol.10,Fq.112, Z.K. 2315; dhe nr. Pas.26/76+3-16, Vol.35,Fq.152, Z.K. 2315, Kukës, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE  
RAPORT PËFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË ASHK  
KUKËS

**Deri 30.06.2022**

**Koment:** Zbatuar: Pasuria Nr.39/74+2-6 në zonën kadastrale 2315 Kukës me Urdhërin Nr.205 datë 20.06.2022 si dhe është njoftuar pronari A.I.M dhe T.I.M me njoftimin Nr.1506 datë 20.06.2022. Pasuria Nr.26/76+3-16 në zonën kadastrale 2315 Kukës me Urdhërin Nr.208 datë 21.06.2022 si dhe është njoftuar pronari F.A.E me njoftimin Nr.1508 datë 21.06.2022.

**10.1. Rekomandimi:** Drejtoria Vendore e ASHK Kukës, të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasurinë e regjistruar me Referencën nr. 18077, datë 27.11.2019. Të fillojë procedurat me grup pune për rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit janë regjistruar pasuritë, duke njoftuar subjektet për fillimin e procedurave përkatëse.

**Deri 30.06.2022**

**Koment:** Zbatuar. Janë kufizuar pasuritë si më poshtë:

1. Pasuria Nr.26/58+1-21 në zonën kadastrale 2315 Kukës me Urdhërin Nr.209 datë 21.06.2022 si dhe është njoftuar pronari M.I.Zh me njoftimin Nr.1516 datë 21.06.2022.
2. Pasuria Nr.26/58+1-22 në zonën kadastrale 2315 Kukës me Urdhërin Nr.209 datë 21.06.2022 si dhe është njoftuar pronari Sh.A.M me njoftimin Nr.1517 datë 21.06.2022.
3. Pasuria Nr.26/133+1-3 në zonën kadastrale 2315 Kukës me Urdhërin Nr.209 datë 21.06.2022 si dhe është njoftuar pronari R.Z.E me njoftimin Nr.1518 datë 21.06.2022.
4. Pasuria Nr.26/133+1-4 në zonën kadastrale 2315 Kukës me Urdhërin Nr.209 datë 21.06.2022 si dhe është njoftuar pronari S.N.H me njoftimin Nr.1519 datë 21.06.2022.
5. Pasuria Nr.26/133+1-6 në zonën kadastrale 2315 Kukës me Urdhërin Nr.209 datë 21.06.2022 si dhe është njoftuar pronari A.H.T me njoftimin Nr.1520 datë 21.06.2022.

**11.1. Rekomandimi:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kukës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, të ushtrojë kontroll administrativ për lëshimin e lejeve të legalizimit në përputhje me nenin 76 "Kontrolli administrativ" të ligjit 20/2020, datë 05.03.2020. Për pasuritë e regjistruara, sipas këtyre lejeve të legalizimit me nr. 3/7/2, vol. 32, fq. 165, ZK. 3425; nr. 355/4, vol. 3, fq. 45, ZK 2759; nr. 355/5, vol. 3, fq. 46, ZK 2759; nr. 15/72, vol. 33, fq. 222, ZK 2315; nr. 46-165-ND, vol. 33, fq. 28, ZK 2315; nr. 1412/2, vol. 8, fq. 6, ZK 2535; nr. 9-3-ND dhe 14/59, vol. 34, fq. 114, ZK 2315, të marrë masa të nxjerrë urdhër kufizimi, deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

**Deri 30.06.2022**

**Koment:** Zbatuar: Janë kufizuar pasuritë si më poshtë:

1. Pasuria Nr.1458/5 në zonën kadastrale 3425 Shtiqën me Urdhërin Nr.184 datë 15.06.2022, në pronësi të A.M.P.
2. Pasuria Nr.249/6 në zonën kadastrale 1248 Borje me Urdhërin Nr.185 datë 15.06.2022, në pronësi të S.N.E.
3. Pasuria Nr.355/4 në zonën kadastrale 2759 Myç Mamëz me Urdhërin Nr.186 datë 15.06.2022, në pronësi të J.S.S.
4. Pasuria Nr.355/5 në zonën kadastrale 2759 Myç Mamëz me Urdhërin Nr.187 datë 15.06.2022, në pronësi të R.E.S.
5. Pasuria Nr.15/72 në zonën kadastrale 2315 Kukës me Urdhërin Nr.188 datë 15.06.2022, në pronësi të R.G.Th.
6. Pasuria Nr.46/145-ND në zonën kadastrale 2315 Kukës me Urdhërin Nr.189 datë 15.06.2022, në pronësi të Z.A.S.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE  
RAPORT PËFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË ASHK  
KUKËS

7. Pasuria Nr.9/3-ND në zonën kadastrale 2315 Kukës me Urdhërin Nr.190 datë 15.06.2022, në pronësi të B.R.C.
8. Pasuria Nr.1412/2 në zonën kadastrale 2535 Lusën me Urdhërin Nr.191 datë 15.06.2022, në pronësi të V.I.Sh.

**12.1. Rekomandimi:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kukës, të marrë masa dhe për të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasurinë nr. 33/74-N9 vol. 34, faqe 65 ZK 2315 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

**Deri 30.06.2022**

**Koment:** Zbatuar, është nxjerrë urdhër kufizimi.

**13.1. Rekomandimi:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kukës, të marrë masa për të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë nr. 50/336, nr. 50/337, nr. 33/109+1-2, nr. 33/109+1-3 si dhe nr. 34/30+1-16 në ZK 2315 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

**Deri 30.06.2022**

**Koment: Zbatuar:** Janë kufizuar pasuritë si më poshtë:

1. Pasuria Nr.50/336 në zonën kadastrale 2315 Kukës me Urdhërin Nr.211 datë 21.06.2022 si dhe është njoftuar pronari H.M.S me njoftimin Nr.1526 datë 21.06.2022.
2. Pasuria Nr.50/337 në zonën kadastrale 2315 Kukës me Urdhërin Nr.211 datë 21.06.2022 si dhe është njoftuar pronari S.M.S me njoftimin Nr.1525 datë 21.06.2022.
3. Pasuria Nr.33/109+1-3 në zonën kadastrale 2315 Kukës me Urdhërin Nr.213 datë 21.06.2022 si dhe është njoftuar pronari H.R.E me njoftimin Nr.1523 datë 21.06.2022.
4. Pasuria Nr.33/109+1-7 në zonën kadastrale 2315 Kukës me Urdhërin Nr.212 datë 21.06.2022 si dhe është njoftuar pronari H.R.E me njoftimin Nr.1524 datë 21.06.2022.

**14.1. Rekomandimi:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kukës, të marrë masa për aplikimin e kamatëvonesave në paraqitjen e Vendimit të Gjykatës nr. 237 Vendimit dhe nr. 61 Aktit, datë 24.06.2005, si dhe në raport me kufizimin e vendosur me Referencën 18460, datë 23.06.2020, për pasurinë me nr. 11/55+3-1 vol. 15, faqe 69, ZK 2315, Apartament me sip. 55 m<sup>2</sup> të veprojë me Korrigjimin e të gabimeve në të dhënat kadastrale duke orientuar palët në konflikt për zgjidhje në rrugë gjyqësore.

**Deri 30.06.2022**

**Koment:** Zbatuar. Është kufizuar pasuria Nr. Pasuria nr.11/55+3-1 në zonën kadastrale 2315 Kukës si dhe është njoftuar pronari A.I.Z me njoftimin Nr.1491 datë 21.06.2022.

### MASA PËR ELEMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E PRONËS PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË PRONËS PUBLIKE

**1.1- Rekomandimi:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kukës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së Tiranë, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore deri në daljen e VKM-ve, për parcelat ndërtimore prej 3134.85 m<sup>2</sup> të pajisur me Leje legalizimi të objektit, për të mundësuar brenda afateve ligjore likuidimin të vleftës përkatëse prej 1,483,098 lekë të parcelave ndërtimore.

**Deri 30.9.2022**



**2.1- Rekomandimi:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kukës, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore, **për të mundësuar likuidimin e vlerës prej 369,820 lekë+bono.**

*Deri 30.9.2022*

*Koment: Janë në Proces zbatimi të dy rekomandimet.*

### **MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Kreun IV, neni 11 germa "d" dhe "e" dhe nenet 37, 144, dhe 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr.111/2018 "Për Kadastrën", të ndryshuar, si dhe në kontratën kolektive dhe individuale të punës, i rekomandojë **Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tiranë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës sipas trajtimit në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe marrjen e masave disiplinore nga **"Vërejtje me shkrim" deri në "Largim nga puna"**, për 10 punonjës.

*Komente: Agjencia Shtetërore e Kadastrës Tiranë, nuk ka dërguar njoftim në DVASHK Kukës për fillimin e procedurave për marrjen e masave disiplinore të rekomanduara. Rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar.*

## **IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET**

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**5- Gjetje nga auditimi:** Në 16 raste, legalizimi i objekteve informale është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, *konkretisht:*

- Në **4 raste**, janë kryer legalizime të objekteve sipas Lejeve të Legalizimit me nr. 57842, datë 27.12.2018; nr. 39193, datë 24.05.2018; nr. 57853, datë 30.01.2019; nr. 62592, datë 25.10.2019, **pa respektuar distancat nga rrugët**, në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, neni 39 "Përrjashtimi nga legalizimi" me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje" kreu III. "Kriteret për legalizimin e ndërtimeve jashtë zonave informale të miratuara", pika 4/b ,Ligjin Nr.8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar "Kodi rrugor në Republikën e Shqipërisë", neni 2 "Përcaktime dhe klasifikime rrugësh" dhe neni 4, "Përcaktimi i qendrave të banuara", VKM nr. 153, date 07.04.2000 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë" neni 25, pika 2; ndërkohë që në dosje nuk ka korrespondencë shkresore me Autoritetin Rrugor Shqiptar për të përcaktuar nëse parcela ndërtimore bie në rrugë apo mbi projektin infrastrukturor,

**Në 1 rast** është kryer legalizim i objektit informal sipas lejes së legalizimit nr. 33925, datë 27.11.2019, **në territor të institucioneve publike**, pasi sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, rezulton se objekti i legalizuar prek projektin konkret të infrastrukturës rrugore si dhe ndodhet i përfshirë në Planin e Përgjithshëm Vendor i të Bashkisë Kukës miratuar me Vendimin e KKT nr. 8, datë 08.02.2017, Rregulloren e Plani të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kukës, është zona **Sh.13.8, ku përdorimet "Shëndetësi" dhe nuk lejohen ndërtime banimi**. Në kundërshtim me VKM nr. 280, datë 01.04.2015, e ndryshuar, Kreu II, pika 2.c; si dhe nenin 18 të ligjit 20/2020, datë 05.03.2020.

**Në 2 raste** është marrë Vendim për kualifikim të objekteve informale sipas Vendimeve nr. 113, datë 28.06.2021 "Për legalizimin e ndërtimit pa leje" në posedim të A.P", si dhe "Për legalizimin e ndërtimit pa leje" në posedim të F.C", pasi objektet e legalizuara bien sipas Planit të Përgjithshëm Vendor në njësinë strukturore IN.7 **"Infrastrukturë rrugë lokale "F" dhe**



zona **AR.9.4, ku përdorimet "Infrastrukturë Turistike"** Në kundërshtim me VKM nr. 1040, datë 25.11.2020 në Kreun II, pika 15.gj dhe pika 24.

**Në 1 rast** është marrë Vendim për kualifikim të objektit informal sipas Vendimit nr. 56, datë 30.03.2021 **në buzë kanali**, pasi nga DVASHK Kukës nuk është përcaktuar statusi i kufitarit nga lindja "Përrua" apo Kanal kryesor ose ndihmës kjo në përputhje e zbatim me VKM 1040, datë 25.11.2020 "Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje", kreu III, pika 18, gërma ë; si dhe të ligjit 24/2017, neni 46, pika ç.

**Në 7 raste** janë lëshuar leje legalizimi si dhe janë marrë Vendime Kualifikimi sipas lejeve të legalizimit me nr. 62592, datë 25.10.2019; nr. 62848, datë 25.08.2020; nr. 62814, datë 19.06.2020; me nr. 62849, datë 23.08.2020; nr. 58119, datë 18.03.2019; si dhe Vendimeve të Kualifikimit Vendimit me nr. 113, datë 28.06.2021 dhe Vendimit nr. 56, datë 30.03.2021 në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kukës miratuar me Vendimin e KKT nr. 8, datë 08.02.2017, konkretisht **ku përdorimet lejohen "Tokë Bujqësore"; "Sistem Natyror" si dhe "Park Natyror Urban" dhe nuk lejohen ndërtime.** Veprime në kundërshtim me nenin 14, të ligjit nr. 9244, datë 17.06.2004 "Për mbrojtën e tokës bujqësore", të ndryshuar dhe me nenin 11/1, pikat 4, 4/1, 4/2 të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionet e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar.

**Në 1 rast** sipas Lejes së Legalizimit nr. 58119, datë 18.03.2019 nga Drejtoria Vendore e ASHK Kukës është llogaritur vlera e Parcelës Ndërtimore për kalimin e pronësisë në datë 30.01.2019 me çmimin preferencial prej 2,000 lekë/m<sup>2</sup> ose me 50 % të vlerës prej 5,280 lekë/m<sup>2</sup> referuar VKM nr. 89, datë 03.02.2016. Veprime në shkelje të legjislacionit të sipër përmendur pasi 3 fish i ndërtimit është (44 x 3) 132 m<sup>2</sup> dhe pjesa tjetër n.q.s. terreni nuk e lejon ndarjen duhet të paguhet në përputhje me neni 17 të ligjit nr. 9482/2006 me ndryshime, nga ku **janë krijuar të ardhura të munguara prej 369,820 lekë+bono** { 859,320 lekë detyrimi – 489,500 lekë të llogaritura e paguar } pasi detyrimi duhet të ishte 859,320 lekë{( 132 m<sup>2</sup> x 2000 lekë )+(112.75 x 5,280)} (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2, faqet 26-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1 Rekomandimi:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kukës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, në përputhje me nenin 76 "Kontrolli administrativ" të ligjit 20/2020, datë 05.03.2020 të ushtrorë kontrollin administrativ dhe në bazë të nenin 18 të marrë masa për s'kualifikimin e objekteve informale të pajisura me leje legalizimi **në 16 raste** si më lart. Gjithashtu për pasuritë e regjistruara sipas lejeve legalizimi konstatuar të lëshuara me shkelje në 16 raste të marrë masa, të nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

*Menjëherë*

## **B. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E PRONËS PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË PRONËS PUBLIKE**

**1- Gjetje nga auditimi:** Nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kukës (ish- Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Kukës) për periudhën objekt auditimi, janë lëshuar 468 leje legalizimi për objektet informale të legalizuara. Nga 468 leje legalizimi të lëshuara, për parcela ndërtimore në total prej 3134.85 m<sup>2</sup> lejet e legalizimit janë me shënimin "Kalimi i pronësisë për parcelën ndërtimore do miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave", nisur nga çmimet e tokës truall për këto zona, sipas Vendimit të KM nr. 89, datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", dhe për sipërfaqet e parcelave ndërtimore, rezulton një shumë që duhej paguar prej subjekteve informale **në vlerën 1,483,098 lekë** veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 me



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE  
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË ASHK  
KUKËS

ndryshime, neni 17 ( pika 5 ), si dhe ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020 (*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2, faqet 26-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1- Rekomandimi:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kukës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së Tiranë, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore deri në daljen e VKM-ve, për parcelat ndërtimore prej 3134.85 m<sup>2</sup> të pajisur me Leje legalizimi të objektit, **për të mundësuar brenda afateve ligjore** likuidimin të vleftës përkatëse prej 1,483,098 lekë të parcelave ndërtimore.

*Deri 30.11.2023*

**2- Gjetje nga auditimi** Nga auditimi i dokumentacionit të administruar sipas Lejes së Legalizimit nr. 58119, datë 18.03.2019, u konstatua se, nga Drejtoria Vendore e ASHK Kukës është llogaritur vlera e Parcelës Ndërtimore për kalimin e pronësisë në datë 30.01.2019 me çmimin preferencial prej 2,000 lekë/m<sup>2</sup> ose me 50 % të vlerës prej 5,280 lekë/m<sup>2</sup> referuar VKM nr. 89, datë 03.02.2016. Veprime në shkelje të legjislacionit të sipër përmendur pasi 3 fish i ndërtimit është (44 x 3) 132 m<sup>2</sup> dhe pjesa tjetër n.q.s. tereni e nuk lejon ndarjen duhet të paguhet në përputhje me neni 17 të ligjit nr. 9482/2006 me ndryshime, nga ku **janë krijuar të ardhura të munguara prej 369,820 lekë+bono** { 859,320 lekë detyrimi – 489,500 lekë të llogaritura e paguar } pasi detyrimi duhet të ishte 859,320 lekë{( 132 m<sup>2</sup> x 2000 lekë)+(112.75 x 5,280)} (*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2, faqet 26-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1- Rekomandimi:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kukës, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore, **për të mundësuar likuidimin e vlerës** prej 369,820 lekë+bono.

*Deri 30.11.2023*

### **C. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kreun IV, neni 11, germa “d” dhe “e” dhe nenet 37, 144, dhe 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr. 136/2015, Ligjin nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, shfuqizuar me ligjin nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” dhe të **kontratës individuale të punës:**

**B.1 I rikërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tiranë,** vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë dhe fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore **“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”**, për 9 punonjës.

**B.2 Kërkojmë marrjen e masave “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”** ndaj titullarit dhe çdo personi përgjegjës që nuk ka zbatuar rekomandimet e pranuar.

**Brenda datës 31.12.2023**

### **V. LISTA E DOKUMENTEVE TË AUDITIMIT**

Pjesë përbërëse e Projekraportit të Auditimit është dhe dokumentacioni i mbajtur si më poshtë:

#### **a. Akt Verifikimi:**

Akt Verifikimi Nr. 1 datë 28.04.2023 “Mbi Zbatimin e Rekomandimeve të lëna”



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE  
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË ASHK  
KUKËS

Për sa më sipër paraqitet Raport Përfundimtar Auditimi

### GRUPI I AUDITIMIT

L.K,	Përgjegjës grupi,
R.K	Auditues,
R.A	Auditues,
B.B,	Auditues,
F.Ç,	Auditues